

ADEM BUNGURI

KALAJA E KOXHAXHIKUT (DIBËR)

Kalaja e Koxhaxhikut¹ ndodhet në krahinën e Zhupës, midis Dibrës dhe Strugës, në krahun e djathtë të Drinit të Zi, në territorin e FYROM. Ajo është vendosur në një kreshtë shkëmbore me lartësi absolute 1160 m dhe relative 360m, që ngrihet në luginën midis fshatrave Koxhaxhik në juglindje dhe Breshtan në veriperëndim, malit të Stogovës në lindje dhe përroit të Koçistës në veri². (*fig. 1-4. Pamje të kalasë së Koxhaxhikut*). Kalaja ka një pozicion të favorshëm strategjik në zotërim të rrugës Ohër-Dibër. Ajo ruan gjurmë të banimit të saj gjatë periudhës së bronzit të vonë dhe hekurit të hershëm, periudhës së vonë antike dhe asaj mesjetare, si dhe pjesë të sistemit fortifikues të dy periudhave të fundit³.

¹ Ky artikull përbëhet nga dy pjesë të lidhura midis tyre. Në pjesën e parë jepen të dhëna të reja për një monument sipërfaqësor të rajonit lindor të Dibrës, krejt i panjohur në literaturën tonë arkeologjike, ndërsa në pjesën e dytë të tij, rishtrohet për diskutim identifikimi i kësaj kalaje me qytetin mesjetar të Sfetigradit. Në funksion të këtij diskutimi, paraqitet shkurtimisht edhe kështjella mesjetare e Modricës, gjithashtu e panjohur në pikëpamje arkeologjike.

² Vizitën e parë në këtë kala e kam kryer në shtator 1993, së bashku me prof. S. Islamin (Tiranë) dhe studiuesin. N. Fetahu (Dibër). Në vizitën e dytë të prillit 2006, kisha shoqërinë e topografit P. Naipi (Tiranë), studiuesit M. Murra (Peshkopi) si dhe të miqve tanë nga qyteti i Dibrës, z. H. Prapadniku, kryetar i këshillit komunal të qytetit, studiuesit Q. Lleshi dhe profesorëve të gjimnazit S. Prapadniku e B. Skara. Vizita e tretë e datës 10 korrik 2007, u realizua së bashku me miqtë e mi nga qyteti i Dibrës, profesorët e gjimnazit të këtij qyteti, S. Prapadniku e B. Skara dhe telekronisti i TV të Shkupit z. A. Dema. Kjo vizitë ishte planifikuar të bëhet së bashku me studiuesin K. Biçoku, që ka mohuar sistematikisht ekzistencën e mureve të kalasë së Koxhaxhikut, i cili u tërhoq në çastet e fundit, megjithëse vetë e kishte kërkuar këtë vizitë dhe që në atë kohë ishte në Tetovë, fare afër zonës së Dibrës, ku gjendet kjo kala. Skicat planimetrike dhe vizatimi i enëve janë bërë nga P. Naipi, ndërsa fotografitë nga autori. Me rastin e botimit të këtij punimi i falënderoj përzemërsisht për ndihmesën e tyre të gjithë miqtë e mi të përmendur më lart.

³ Punimi ynë mbështetet tërësisht në vrojtme sipërfaqësore, pasi në këtë kala nuk janë kryer deri tani gërmime arkeologjike. Sipas banorëve vendas, në vitet e fundit janë kryer aty gërmime nga arkeologët e Ohrit, për të cilat nuk është raportuar ende në shtypin shkencor. Në sipërfaqen e kalasë shihen dy sondazhe të gërmuar me përmasa 1x1 m.

1. Periudha e bronzit të vonë dhe hekurit të hershëm (shek. XII-IX para Kr)

Kësaj periudhe i takojnë 5 fragmente enësh. Ata u gjetën në sipërfaqen e kalasë dhe në shpatet jugore të saj. Tre prej tyre janë punuar me brum të kuq argjilor, të përzier me kokrriza rënore dhe guralecë të vegjël, me pjekje të njëtrajtshme por jo të plotë, me faqe të lëmuar mesatarisht, dhe ngjyrë kafe në të kuqëremtë, ndërsa ndeshen dhe ato me brum kafe në bezhë. Përfaqësojnë tipin e enëve dyvegjake, me vegjë të ngritura mbi buzë (*tab. I, 1-2, fig. 24*), tip mjaft i përhapur në periudhën e bronzit të vonë dhe atë të tranzicionit bronz-hekur, si në territorin e Shqipërisë (Maliq III⁴, Nezir VI (Mat)⁵, Gajtan III⁶, Zagorë II (Shkodër)⁷ e të Kosovës (Vlashnje, Hisar)⁸, ashtu edhe në atë të Maqedonisë qendrore (grupi pelagonas)⁹ etj. Vetëm një prej pareteve ruan dekorin shiritor në trajtë brinjësh plastike, të zbukuruara me shtypje gishti dhe thellime bigle (*tab. I, 3, fig. 24, 5*), teknikë dekorative kjo mjaft karakteristike për poçerinë e epokës së bronzit në Shqipëri¹⁰ dhe në një areal mjaft të gjerë ballkanik¹¹. Megjithëse mjaft të pakta, ata e cilësojnë kalanë e Koxhaxhikut si një vendbanim kodrinor të periudhës së bronzit të vonë dhe fillimit të epokës së hekurit. Vendbanime të tilla të vendosura në maja kodrash dhe të fortifikuara me mure prehistorike, njihen në literaturën arkeologjike si kala të tipit

⁴ F. Prendi, "Epoka e bronzit në Shqipëri", *Iliria VII-VIII*, 1977-1978, f. 13, tab. VIII, 2, IX, 5; Po ai, "La civilisation prehistorique de Maliq", *Studia Albanica*, 1966, 1, tab. XVII, 1, 6; Po ai, "Die Bronzezeit und der beginn der Eisenzeit in Albanien", *Südosteuropa zwischen 1600 und 1000 v. Chr.*, Berlin: 1982, tab. IV, 9; Po ai, "Vështrim mbi kulturën e periudhës së parë të epokës së hekurit në Shqipëri", *Iliria III*, 1974, f. 107, tab. VIII, 1-5, IX, f.3.

⁵ Zh. Andrea, "Vendbanimi shpellor i Nezirit", *Iliria 1990*, 2, f. 38, tab. XVI, f.15-16.

⁶ B. Jubani, "Qeramika ilire e qytezës së Gajtanit", *Iliria II*, 1972, tab. X, f.5.

⁷ Zh. Andrea, "Vendbanimi i Zagorës", *Iliria 1996,1-2*, 1996, f. 31, tab. VII, f.3.

⁸ A. Bunguri-Sh. Gashi, *Raport mbi gërmimet e vitit 2004 në Hisar (Suharekë)*, Arkivi i Institutit Arkeologjik, Tiranë, Prishtinë; Po ata, *Raport mbi gërmimet e vitit 2006 në Vlashnje (Prizren)*, Arkivi i Institutit Arkeologjik, Tiranë, Prishtinë.

⁹ M. Garašanin, *Razvijeno Bronzano Doba i Prelazni period (Gvozdno Doba I), Makedonije*, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja, IV, Sarajevo: 1983, f. 788, tab. CIX, f.1-2.

¹⁰ F. Prendi, "Epoka e bronzit ...", *Iliria VII-VIII*, f. 13.

¹¹ M. Garašanin, *Podunavska Balkanski Kompleks ranog Bronzanog Doba*, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja, IV, Sarajevo: 1983, f. 463-470, fig. 33, II, 1, 4 dhe III, f.1, 4.

Gajtan¹², tip ku duhet të përfshihet edhe Koxhaxhiku, pavarësisht nga mungesa e fortifikimit prehistorik, që për shkak të mbrojtjes së fuqishme natyrore, duket se nuk ka qenë i nevojshëm.

2. Periudha e vonë antike (shek. V-VI pas Kr.)

Kësaj periudhe mendojmë se i takojnë disa trakte të veçanta të murit rrethues.

a. Sistemi fortifikues :

Kalaja ruan një sistem të thjeshtë fortifikues, që i përket periudhës së vonë antike dhe asaj mesjetare. Ky fortifikim gjendet në pjesën më të lartë të kreshtës shkëmbore të kalasë dhe përbëhet nga muri rrethues, një kullë katrore dhe hyrja pranë saj. Kreshta e kalasë mbyllet me një platformë të sheshtë afërsisht poligonale, që brenda mureve ka përmasa 58 x 34 m, perimetër 145 m dhe sipërfaqe rreth 1600 m². (fig. 5. Pamje e sheshit të kalasë: “çitadela”). Kjo platformë e fortifikuar ka rrënjë plotësisht shkëmbore nga jugperëndimi, perëndimi dhe veriperëndimi, ndërsa nga anët tjera pjerrësia e shpateve të saj është shumë e madhe dhe thuajse e pangjtitshme. Linja e murit ndjek vijën kufizuese të kreshtës, përveç anës jugore, ku përfshin brenda sipërfaqes së mbrojtur dhe dy tarraca të ngushta e të përshtatshme për banim. Ajo formon një planimetri afërsisht poligonale, me kalime të buta në këndet. Muri shfrytëzon aftësitë mbrojtëse të terrenit, duke përfshirë brenda tij shkëmbinj të lartë natyrorë, kur ato gjenden në linjën e murit, dhe ndërpritet aty ku ka rënie të rrëpita e të pangjtitshme dhe s’ka nevojë për mbrojtje. Sot ruhen 7 trakte të mureve rrethuese, që i kemi emërtuar sipas gërmave të alfabetit : A, B, C, D, E, F dhe G, me gjatësi përkatësisht 2 m, 3.5 m, 6 m, 2.10m, 9 m, 6 m dhe 22 m dhe perimetër të lexueshëm 50.60 m. (fig. 6. Skicë planimetrike e kalasë së Koxhaxhikut). Gjendja aktuale e tyre paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Trakti	Muri A	Muri B	Muri C Kulla	Muri D	Muri E	Muri F	Muri G	Shuma
Gjatësia	2m	3.50m	6m	2.10m	9m	6m	22m	50.60m
Lartësia	1.50m	1.20	1.50	0.50m	3m	3m	0.40m	0.40-3m
Trashësia	?	?	1.40m	?	1.70m	1.60m	?	1.40-1.70m

Në kushtet e një vrojtimi sipërfaqësor është e vështirë për të veçuar tipologjikisht muret e periudhës së vonë antike prej atyre mesjetare, pasi muret e periudhës së parë janë mbuluar nga ato të mëvonshme, janë shembur ose dëmtuar. Megjithatë, duke u mbështetur në elementët më të sigurtë teknikë,

¹² S. Islami-H. Ceka, “Të dhëna të reja mbi lashtësinë ilire në territorin e Shqipërisë”, *Konferenca I e Studimeve Albanologjike (15-21 nëntor 1962)*, Tiranë: 1965, f. 448-449.

mendojmë se periudhës së vonë antike i përket muri i parë i jashtëm i traktit C, me gjatësi të përgjithshme 6m. Është fjala për murin e jashtëm të kullës së vetme të fortifikimit, në të cilin ruhen dy fasada muresh që veshin njëra tjetrën, të lidhura përkatësisht me periudhën e vonë antike dhe atë mesjetare¹³ (**fig. 9. Muri i jashtëm i kullës së periudhës së vonë antike**).

Muri është ndërtuar me gurë lumorë dhe të terrenit, të lidhur me llaç të bollshëm gëlqeror, sipas teknikës *opus incertum*. Llaçi është i një cilësie të mirë, i përzier me shumë rërë të imët lumi dhe pak gëlqere paraprakisht të stazhionuar. Lartësia e ruajtjes së murit lëviz nga 0.40-0.80m, ndërsa trashësia e saktë nuk mund të matet, pasi faqja e brendshme është e mbuluar nga dherat. Fortifikimi i periudhës së vonë antike, i konstatuar më parë edhe nga studiues të tjerë¹⁴, është aktualisht fortifikimi më i hershëm i kalasë së Koxhaxhikut. Megjithëse në ndonjë rast kjo kala është cilësuar edhe si “*aglomeracion urban i halshatit ilir, i fortifikuar me blloqe gurësh kuadratik*”¹⁵, ne nuk gjetëm gjurmë të fortifikimit të periudhave më të hershme ilire apo asaj urbane. Gjithashtu nuk gjetëm as fragmente enësh të periudhës së vonë antike.

1. Periudha mesjetare (shek. XIV-XV pas Kr.)

a. Sistemi fortifikues

Kalaja është rifortifikuar thuajse tërësisht në periudhën mesjetare, kur janë plotësuar pjesët e dëmtuara të mureve dhe janë rindërtuar trakte të reja të tyre. Ata në pjesën më të madhe të perimetrit mbivendosen mbi linjën e mureve të periudhës së vonë antike, plotësojnë pjesët e shembura të tyre, dhe në rastin më të mirë, i përforcojnë ato me këmisha të jashtme, siç ndodh në fasadën jugore të kullës së vetme të kalasë. Me këtë periudhë lidhen të gjitha traktet e ruajtura, A-G, me gjatësi 50.60 m, përfshirë këtu edhe murin e dytë të jashtëm të kullës së përmendur më lart. Muret janë ndërtuar sipas teknikës *opus incertum*, me gurë lumorë dhe të terrenit, të lidhur me llaç të bollshëm gëlqeror, të një cilësie të mirë. Llaçi përveç rërës së imët të lumit përmban edhe shumë gëlqere të stazhionuar, veçori teknike që e dallon nga ai i periudhës së vonë antike. Ai është përdorur me bollëk dhe përveç fugave me gjerësi 2-3 cm, mbulon dhe një pjesë të faqes së jashtme të gurëve. Gurët nuk krijojnë rreshta horizontale dhe nuk nivelohen me copa gurësh të thyer. Gurët e fasadës së jashtme shpesh kanë rënë në faqet e kreshtës dhe muri nuk ruhet i plotë. (**fig.7-**

¹³ Gjithashtu me këtë periudhë mund të lidhen edhe gjurmë të shkëputura të murit jugor, të vendosura më në brendësi se sa muri mesjetar, por për të sqaruar këtë duhen kryer gërmime pastrimi.

¹⁴ И. Микүльич, *Антички градови во Македонија*, Скопје: 1999, Книга 8, tab. f. 404.

¹⁵ V. Bitrakova - Groždanova, *Prilog kod antičkata na Debarskijot kraj*, Spisanje na Sojuzot na družvata na istoričarite na Republika Makedonija, Skopje: 1966, f. 199.

8. Trakte të murit jugor-segmenti E). Lartësia e ruajtjes së murit lëviz nga 0.40 deri në 2.5-3m, ndërsa trashësia e tij e matur me vështirësi vetëm në tri pika është 1.40-1.70m¹⁶ (**fig. 11-12. Trakt i murit F dhe D**). Një trashësi e përafërt e mureve rrethuese është ndeshur në kala të tjera mesjetare të vendit tonë, si: në Krujë (0.80-1.50m), në Shurdhah (1.30-2.60m), në Daulë të Krujës (0.75 m, 0.90 m, 1.10m, dhe 1.80m)¹⁷, në Stelush (1.50-1.80m) dhe po aq në Petralbë (Gur i Bardhë)¹⁸ etj. Kulla e vetme juglindore me përmasa 6 x 6 m, duket qartë se është rifortifikuar në periudhën mesjetare, pasi muri i saj i periudhës së vonë antike, vishet në këtë periudhë në anën e jashtme jugore nga një mur i dytë përforcues, me trashësi 1.40m. (**fig.9-10. Muri I dhe II i jashtëm i kullës-trakti C**). Hyrja e kalasë duhet të jetë në anën e majtë të kësaj kulle, pasi aty kalon shtegu i vetëm që lidh kalanë me varoshin¹⁹.

Në faqen e jashtme të murit jugor, në segmentin E shihet një vrimë rrethore me diametër 6 cm dhe thellësi të lexueshme 1.00m, e cila i takon mbetjeve të skelerisë metalike të ndërtimit (**fig.13. Pamje e vrimës së skelerisë së ndërtimit**). Vrima të tilla skelash, me formë rrethore dhe përmasa të njëjta (6x6cm), që e përshkojnë murin në të gjithë trashësinë e tij, janë ndeshur edhe në disa ndërtime të tjera mesjetare të Shqipërisë, si: në kalanë e Stelushit²⁰, kalanë e Ndroqit, në kishën e Mesopotamit, në fshatin mesjetar të Kamenicës (Delvinë) etj, të datuara pas shek. XIV pas Kr²¹. Seksioni i tyre i njëjtë në të gjithë trashësinë e murit, dëshmon se për ndërtimin e këtyre skelerive janë përdorur tuba hekuri, teknikë e futur në ndërtimin e kalave nga arkitektët bizantinë.

Në pjesën e brendshme veriore të “çitadelës“ gjenden rrënojat e një godine, prej të cilës shihet vetëm një trakt muri me gjatësi 1.70 m dhe lartësi të faqes së jashtme 1.10m. Gjerësia nuk mund të matet saktë, pasi faqja e brendshme është e mbuluar nga dherat, por nuk e kalon 1 m. Teknika *opus mixtum* e ndërtimit të tij ndryshon nga ajo e mureve rrethuese. Në strukturën e tij, përveç gurëve, gjenden rrallë edhe tulla me trashësi 4cm, të periudhës së

¹⁶ Duhet theksuar se trashësia e murit është e vështirë të matet saktë, pasi faqja e brendshme e tij është e veshur nga dherat e pjerrësisë së kodrës.

¹⁷ Gj. Saraçi, “Kalaja e fshehtë e Skënderbeut pranë fshatit Daulë (rrethi i Krujës)”, *Iliria* 1987, 1, f. 205; S. Adhami, “Gjurmime rreth themelimit dhe rindërtimeve kryesore të kalasë së Krujës”, *Monumentet* 1971, 1, f. 87; H. Spahiu - D. Komata, “Shurdhahi-Sarda, qytet i fortifikur mesjetar shqiptar”, *Iliria III*, 1974, f. 263.

¹⁸ Sipas vrojtimeve të autorit në kalanë e Stelushit dhe në atë të Petralbës.

¹⁹ Hyrja e kalasë nuk është fiksuar në terren. Për sqarimin e saj si dhe për të dhëna të tjera më të plota të sistemit fortifikues, duhen ndërmarë gjurmime pastrimi të mureve.

²⁰ Sipas vrojtimeve të autorit në murin e dytë rrethues të kalasë së Stelushit.

²¹ Informacioni u mor nga studiuesi i departamentit të mesjetës të Institutit Arkeologjik, prof. S. Muçaj, të cilin me këtë rast e falënderojmë.

vonë antike, të ripërdorura pa ndonjë rregull, të lidhura me llaç gëlqeror me shumë gëlqere dhe pak rërë. (**fig. 14. Trakt i murit të një godine brenda rrethimit**). Paraprakisht mendojmë se godina mund të lidhet me ndonjë objekt kult, ndoshta me kishën e Shën Mërisë, të përmendur nga burimet²², por ky është vetëm një supozim, që mund të konfirmohet ose jo nga gërmimet. Në anën jugore të kalasë, në pjesën më të ulët të saj dhe njëherësh më të mbrojtur nga erërat, gjenden gjurmë themelesh të godinave me gjerësi 0.60 m, sa duket me karakter ushtarak (kapanone të ushtarëve). Gjithashtu, në gjysmën jugore të syprinës së saj gjenden pranë njëri tjetrit dy gurë të mëdhenj natyrorë me sipërfaqe të sheshtë, që ruajnë në mesin e tyre nga një vrimë cilindrike me përmasa 0.30 x 0.30 m x 0.20 m dhe 0.20 x 0.16 m x 0.15 m, të përdorura si dybeqe për shtypjen e barutit²³ (**fig.15. Pamje e dybekut nr. 1 të kalasë**).

Në pikëpamje kronologjike, fortifikimi mesjetar i kalasë së Koxhaxhikut i takon periudhës paraosmane të shek. XIV-XV pas Kr. Me këtë periudhë përputhen teknika e ndërtimit të mureve rrethuese e përshkruar më lart, trashësia e vogël e tyre, mospërdorimi i tullave në përbërje të mureve, cilësitë teknike të llaçit, që shquhet për mbizotërim të gëlqeres në raport me rërën, përdorimi i skelerive prej tubash hekuri, si edhe shumica e materialit të imët qeramik të gjetur në këtë kala. Në periudhën mesjetare kalaja mendohet të ketë qenë pajisur dhe me dy kalime të nëndheshme në trajtë tunelesh sekrete, daljet e të cilëve gjenden në anën jugore dhe në atë perëndimore të kreshtës së saj²⁴.

b. Varoshi:

Në anën verilindore të kalasë, pas një qafe të ngushtë, në një disnivel kuatash prej afro 20 m, hapet një tarracë e gjerë me kushte mjaft të përshtatshme për banim, e njohur me emrin “varosh”. Në këtë tarracë me sipërfaqe afro 0,7 ha (diametri veri-jug-145 m, diametri lindje-perëndim- 47 m) shtrihej qyteti mesjetar, i lidhur organikisht me kalanë. Edhe varoshi ka një pozitë të shkëlqyer natyrore dhe mjaft strategjike. I mbrojtur nga perëndimi dhe veriu prej rrënjëve shkëmbore të faqeve të tij, ai ka një pjerrësi të lehtë lindore. (**fig. 16. Pamje e varoshit nga kalaja**). Në varosh ruhen gjurmë të shumta banesash me formë katërkëndëshe, të orientuara nga lindja, zakonisht të mbështetura në shkëmbenj natyror. Në pjesën qendrore më të dukshme të tij, shihen themelet e një godine katërkëndëshe me përmasa të jashtme 7 x 4.50 m,

²² M. Barleti, *Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut* (përkthim nga latinishtja i S. J. Priftit), Tiranë: 1964, IV, f. 192.

²³ Q. Lleshi, “Përshkrime dhe konstatime mbi Sfetigradin nga burime historike dhe gjurmime në terren”, Simpoziumi shkencor *Skënderbeu dhe Dibra* (Dibër 2 mars 2003), Shkup: 2005, f. 205, fig. 8.

²⁴ *Po aty*, f. 202, fig. 5-6.

të shënuara nga gurë të mëdhenj, me gjerësi 0.90 m²⁵. (*fig.17. Pamje e themeleve të godinës*). Ana lindore e varoshit kufizohet nga gjurmët e një muri të gjatë tarracimi, që ka shërbyer si trase edhe për rrugën e karrove që ngjitej në varosh, e cila është qartë e dukshme. (*fig.18. Traseja e rrugës së varoshit*). Trakte të kësaj rruge shihen edhe në lëndinën fushore në jug të kalasë, ndërkohë që bashkimi i tyre nëpër shpatin e pjerrët të kodrës, në terren ende nuk është gjetur. Sipas banorëve vendas, qyteti ka qenë furnizuar me ujë të pishëm nga gurra “*Kërmzesu*” (*turqisht-uji i kuq*) e kodrës *Byk-Duruk*, vetëm 4 km në lindje të kalasë²⁶. Ujësjiellësi përbëhej prej qyngjesh qeramike, fragmente të cilave janë gjetur herë pas here nga banorët lokalë, për fat të keq të paruajtura, për vlerësimin e tyre kronologjik.

c. Qeramika

Periudhës mesjetare paraosmane (shek.XIV-XV pas Kr.) i përkasin fragmentet më të shumta të enëve, të mbledhura në sipërfaqen e kalasë e të varoshit, si dhe në shpatet lindore e jugore të kreshtës së saj. Në pikëpamje teknologjike, veçohen dy grupe enësh:

1. Enët e grupit të parë që mbizotërojnë janë punuar me baltë bezhë në gri dhe gri në të zezë, të pastruara nga lëndët e huaja, dhe kanë pjekje e lëmim të mirë. Janë kryesisht enë kuzhine, të përdorura për zierje dhe shpesh ruajnë njollat e tymosjes dhe të zjarrit.

2. Enët e grupit të dytë me baltë të okër të hapur në rozë, janë më të rralla. Kanë brum të pastër me ngjyrë rozë, pjekje e lëmim të mirë dhe paraqiten të zbukuruar me pikturim paste të bardhë. U takojnë enëve të tavolinës e të pijes.

Format kryesore të enëve të grupit të parë janë vorbat, që ndeshen në dy variante: vorba me grykë konike dhe buzë të profiluara për puthitjen e kapakut, me përdorim më të gjerë (*tab. II, 1-5, fig. 25*) dhe vorba me grykë konike dhe buzë të hapura anash (*tab. II, 6*). Të dy variantet mbështeteshin mbi funde të sheshtë apo lehtë konkav (*tab. III, 1-3, fig. 26, 1-6*). Ato janë pajisur me vegjë

²⁵ Sipas disa banorëve vendas, thuhet se aty ka qenë xhamia e qytetit, e ndërtuar pas pushtimit turk, por kjo, në fazën e sotme të studimeve, nuk mund të konsiderohet e sigurtë. Gjurmë të shumta të banesave apo të godinave të ndryshme, ruhen gjithashtu edhe në rrëzën jugore të kreshtës së kalasë, jashtë varoshit, aty ku fillon lëndina e madhe fushore prej disa ha. Duket se ato janë vendosur atje në kohën e lulëzimit të qytetit, kur ai njohu rritjen më të madhe të tij.

²⁶ Q. Lleshi, *art. i cit.*, f. 200. M. Murra, “Lokalizimi i betejave të Skënderbeut në Dibër”, *Skënderbeu dhe Dibra*, Shkup: 2005, f. 134. Furnizimi i kalave mesjetare me ujë nga burime të jashtme realizohej me tubacione qyngjesh qeramike, ndërsa ruajtja e tij me anë sterash të ndërtuara me kujdes brenda zonës ushtarake. Shih: Gj. Karaiskaj, “Furnizimi me ujë i kalasë së Shkodrës në mesjetë”, *Monumentet*, 1985, 1, f. 59 vv, fig. 5.

shiritore vertikale, që dalin nën grykë, në ndonjë rast të zbukuruara me thellime thike (*tab. III, 4-5, fig. 27, 1-5*). Një pjesë e vorbave paraqiten të zbukuruara me inçizim 2-3 vijash të çarkut, që e qarkojnë enën horizontalisht (*tab. III, 6-10, fig.28*). Në një rast të vetëm ndeshet kombinimi i vijave të çarkut dhe një rreshti thellimesh me bigël, dekor ky i njohur në kulturat tona mesjetare të shek. XII-XIV²⁷. (*tab. III, 11, fig.28, 7*), si dhe shiriti plastik i zbukuruar me gropëzime gishti (*fig. 28, 8*). Vorba të ngjashme, të zbukuruara me këto motive, janë zbuluar gjithashtu në kalatë e Skënderbeut në Stelush (Qafë-Murrë)²⁸, në Gurin e Pishkashit (Përrenjas), në kalanë e Petrelës (Tiranë) dhe në qytetin e Shurdhahut (Shkodër)²⁹, në kalanë e Krujës³⁰, në kalanë e fshehtë të Skënderbeut në Daulë të Krujës³¹, në gradishtën e Symyzës (Korçë)³² etj, të datuara në shek. XIV-XV pas Kr.

Në grupin e dytë të qeramikës me brum okër në rozë, veçohet qafa e një kane me grykë konike, me brum të pastër rozë, të zbukuruar me pikturim mat të bardhë shiritash horizontalë e vertikalë. Tipi i kanave me qafë të gjatë vazhdon nga qeramika e vonë antike në atë mesjetare dhe ndeshet në kalanë e Stelushit, të Pishkashit dhe të Petrelës³³, në kalanë e Krujës³⁴, si dhe në vise të tjera të Ballkanit³⁵. Nga brumi dhe analogjitë, përfaqëson një import me origjinë nga Mesdheu lindor, gjasisht nga punishtet qeramike të Qipros dhe datohet pas shek. XIV³⁶ (*tab.II, 8, fig. 29, 1*). Të njëjtës periudhë i përkasin edhe dy fragmente enësh të zbukuruara me pikturim shiritash të bardhë (*fig. 29, 2-3*) si dhe dy vegjë shiritore vertikale, me zbukurim të gërshetuar thellimesh thike në qendër dhe shiritash anësor të pikturuar me pastë të bardhë (*fig. 27, 1-2*).

²⁷ D. Komata, "Disa tipare të qeramikës mesjetare në Shqipëri", *Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve*, Tiranë: 1969, f. 222-226, tab. VII,1-7, 10-14, VIII, 16-17, 20-23; Gj. Karaiskaj, "Gradishta e Symyzës në periudhën e vonë antike dhe në mesjetë", *Iliria IX-X*, 1979-1980, tab. IX, 3.8.

²⁸ S. Anamali, "Stelushi, qytet i Skënderbeut në Mat", *Studime historike*, 1967, 4, f.106; Po ai, "Kalaja e Varoshit në Mat - Stelushi, një hallkë e sistemit mbrojtës të Skënderbeut", *Konferenca II e studimeve albanologjike*, Tiranë: 1969, vol. I. f.249-253.

²⁹ D. Komata, "Disa tipare të qeramikës mesjetare ...", f. 222-226, tab.II, 1,4, 6, 7; IV, 1,3, 7; V, 1-4; VII, 1-4, 8, 10, 11; VIII, 4.

³⁰ D. Komata, "Të dhëna të reja arkeologjike nga kalaja e Krujës", *Iliria 1982*, 1, f. 227, tab. V,1-4, 7, 9-10.

³¹ Gj. Saraçi, *art. i cit.*, 2, f. 211-212, tab. II,1-7, III, 1-7, IV, 1-6.

³² Gj.Karaiskaj, "Gradishta e Symyzës në periudhën ...", tab.IX, 3.

³³ D. Komata, "Disa tipare...", f. 226.

³⁴ Po ai, "Të dhëna të reja arkeologjike ...", f. 227, tab. II,1-2.

³⁵ Po ai, "Disa tipare...", f. 226, shën. nr. 21.

³⁶ E. J. Stern, "Excavation of the Courthouse Site At Akko": *The Pottery of the Crusador and Ottoman periods*, Atiqot, XXXI, 1977, f. 48-50, fig. 9, 73, a-b.

d. Varreza:

Në rrafshinën e madhe kodrinore që shtrihet në jug të kalasë së Koxhaxhikut, të njohur me toponimin “*Kodra e Lipardës*”³⁷, shtrihet një varrezë e madhe me sipërfaqe mbi 2 ha. Ajo përbëhet nga varreza e poshtme në jug dhe ajo e epërme në veri, me ndryshime të qarta midis tyre, si në aspektin arkitektonik ashtu edhe në atë kultik dhe kronologjik. Sipas një vlerësimi paraprak, ato duket se lidhen me dy periudha të ndryshme përdorimi, kronologjikisht të lidhura me shek. XV dhe XVIII pas Kr.

Periudhës së parë të shek. XV-të, mendojmë se i përket varreza e poshtme, në pjesën jugore të lëndinës së varreve. Ajo përbëhet nga qindra varre me konstruksion të njëjtë dhe orientim lindje-perëndim. Varret janë konturuar me gurë në të gjitha anët, pa gurë të veçantë kufizues te koka dhe te këmbët. Krahas varreve individualë, ka edhe shumë varre kolektivë. Ato kanë formë të njëjtë drejtkëndëshe ose katërkëndëshe dhe ndryshojnë vetëm nga përmasat e tyre, disa prej të cilave janë : 2 x 2.90m, 3.5 x 4 m, 4 x 5.50m, 4 x 6 m, 6 x 4.50 m, 5 x 8.80m etj. Megjithëse e pastudiuar në pikëpamje arkeologjike, varreza e poshtme hap diskutime dhe shtron nevojën e kërkimeve më të thelluara në këtë fushë³⁸. (*fig. 19-20. Pamje e pjesshme e varrezës së poshtme*).

Periudhës së dytë të shek. XVIII-të, i takon varreza e epërme, e vendosur në pjesën veriore të rrafshinës së varreve, ku përdoret tipi i varrit individual me gurë kufizues vetëm tek koka dhe këmbët, në disa prej të cilëve gjenden edhe epitafe në osmanisht.

Të dhënat arkeologjike të paraqitura më lart, dëshmojnë se kalaja e Koxhaxhikut përfaqëson një kala ilire të periudhës së bronzit të vonë dhe hekurit të hershëm. Në periudhën e vonë antike ajo fortifikohet për herë të parë me mure mbrojtëse, dhe rifortifikohet në periudhën mesjetare të shek. XIV-XV pas Kr. Kjo është edhe periudha më intensive e jetës në këtë kala, ku mendojmë se është plotësisht i mundur lokalizimi i qytetit mesjetar të Sfetigradit, mendim të cilit i shërben dhe diskutimi i mëposhtëm.

³⁷ Ky toponim na kujton emrin e malit “*Liporas*”, të përmendur në një dokument milanez të majit 1466, ku flitet për një thyerje të Skënderbeut “*në malin Liporas*”. Megjithëse prof. Shuteriqi e identifikon atë me emrin e *Librazhdit*, nuk përjashtohet mundësia që në këtë dokument të bëhet fjalë pikërisht për kodrinën e *Lipardës*, ngjitur me kalanë e Koxhaxhikut. Shih: (Radonić, nr. 321: “*in la montagna de Lipora*”). Cituar sipas Dh. S. Shuteriqi, “Arianitët, emri dhe gjenealogjia”, *Studime për epokën e Skënderbeut*, II, Tiranë: 1989, f. 94, shën. 43.

³⁸ Mundësia hipotetike e lidhjes së varrezës së poshtme me mesin e shek.XV pas Kr. është ende e pakonfirmuar arkeologjikisht dhe mbështetet në tipin konstruktiv të varreve, si dhe në parimin logjik se varret e tipit masiv përdorëshin vetëm në raste lufttrash, sëmundjesh epidemike apo fatkeqësishë natyrore.

Diskutim:

Lidhur me lokalizimin e qytetit të Sfetigradit janë shprehur mendime të ndryshme, që grupohen në dy hipoteza kryesore, pro dhe kundër lokalizimit të tij në kalanë e Koxhaxhikut³⁹. Çështja e lokalizimit të tij u shtrua për herë të parë në historografi para 140 vjetësh nga albanologu J. G. Hahn gjatë udhëtimit të tij në luginën e Drinit⁴⁰. Qysh atëhere e deri më sot, shumica e studiuesve që janë marrë me këtë problem, pranojnë barazimin Koxhaxhik - Sfetigrad. Të tillë janë K. Jeriçek, T. Tomovski, A. Stojanovski, B. Rusiq, H. Inalçik etj⁴¹, ndërsa nga autorët vendas përmendim F. S. Noli, H. Stërmilli, H. Sharofi, V. Kurmaku, dhe pas Luftës II Botërore edhe prof. H. Ceka, prof. K. Frashëri, si dhe studiuesit H. Sadiku, H. Ndreu, M. Murra, A. Bunguri, M. Hysa, M. Bislimi, Q. Lleshi etj⁴².

³⁹ Pikëpamjet e studiuesve të ndryshëm, që janë marrë me këtë problem, janë përmbledhur nga S. Antolak në artikullin: “Ku gjendej Sfetigradi?”, *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, VIII, 1978, Prishtinë: 1979, f. 47-72 dhe literatura e cituar aty. Disa nga referencat që nuk i kam gjetur janë cituar sipas këtij autori.

⁴⁰ J. G. Hahn, *Reisse durch Drin und Wardar Gebiechte*, Wien: 1867, f. 121. Megjithëse Hahn e përshkruan Koxhaxhikun, dhe e pranon se aty duhet të ketë qenë Sfetigradi, ai jep edhe variantin e dëgjuar në popull, sipas të cilit, Sfetigradi mund të ketë qenë në kalanë e Grazhdanit.

⁴¹ S. Antolak, *art. i cit.*, f. 47 - 59; K. Jeriçek, *Istoriya Serbia I*, Beograd 1952, f. 374; T. Tomovski, *Prasanjeto na Kodzadzik*, *Istoriya IV/2*, Skopje 1968, f.93-99; Po ai, “Pitanje Kodzadzika”, Simpozijum o Skenderbegu (9-12 maj 1968), Prishtina: 1969, f.195 - 200; Po ai, “Sveti grad e vtoro ime za srednovekovniot grad Debar”, *Istoriya VIII/1*, Skopje 1972, f. 113-114; A. Stojanovski, “Tvrdinata i nasebata Kodzadzik vo XV i XVI vek”, *Bigorski naučno-kulturni sobori*, I, Nauçen sobir, Gostivar: 22-23.10.1971, f. 205-209; Branisllav Rusiq, *Zupa debarska - Posebna izdanja Filozofskog fakulteta na Univerzitetot Skopje*, 4, *Istorisko - filoloski oddei*, Skopje: 1957, f. 72-73, 110, 200-201, shën. 14-15 (cituat sipas S. Antolak); H. Inalçik, “Krahina e Krujës dhe e Dibrës rreth vitit 1467”, Konferenca II e studimeve albanologjike, Tiranë: 1969, f.186 - 190.

⁴² F. S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405-1468)*, Tiranë: 1967, f. 97, shën. 64; H. Stërmilli, *Dibra në prag të historisë*, maket, Tiranë: 1940, f. 8; H. Sharofi, *Historia e Dibrës*, (vol. I, 1968), Tiranë: 2003, f. 45-46, 48-49; V. Kurmaku, *Sheshet e betejave të Skënderbeut në dritë të realitetit*, dorëshkrim, Steblevë 1940, ruhet në arkivin e MHP, f. 5-10; H. Ceka, *Vërejtje mbi disa të dhana topografike rreth luftërave të Skënderbeut sipas Barletit*, B. SH. SH. Nr.3, 1952, f. 29; K. Frashëri, *Skënderbeu, Jeta dhe vepra*, Tiranë: 2002, f. 158; *Historia e Shqipërisë*, vol. I, Tiranë: 1959, f. 282, harta VII, f. 283; H. Sadiku, “Mendime për shtrirjen e Dibrës së Sipërme në shek.XV dhe parashtrja për lokalizimin e Oranikut dhe të Mokrës mesjetare”, Konferenca II e Studimeve Albanologjike (12-18 janar 1968), 1969, f. 454; H. Ndreu, *Kastriotët dhe Skënderbeu në trojet Arbërore*, Tiranë: 1997, f. 66-83; M. Murra, *art. i cit.*, f. 133-134;

Përkrahës të hipotezës së dytë janë: S. Gopçeviç, që e mendon Sfetigradin të vendosur në qytezën e Zagradit afër Peshkopisë (*duhet thënë në qytezën e Bellovës afër Zagradit, pasi vetë Zagradi nuk ka kala- shën. im A.B*), I. S. Jatrebov dhe A. M. Selišceviç, që e vendosin atë në malin e Shenjtë, në kufirin midis Lurës dhe Mirditës, ku nuk ka asnjë gjurmë fortifikimi, S. Antolak, sipas të cilit Sfetigradi nuk duhet ngatëruar me Koxhaxhikun dhe anasjelltas⁴³ etj. Ndërkaq G. Palikrusheva në një punim të përbashkët me A. Stojanovskin të vitit 1969, nuk është e sigurtë lidhur me lokalizimin e propozuar nga Hahn dhe T. Tomovski dhe konkludon se “*nuk mund të përjashtohet plotësisht edhe një zgjidhje tjetër*”, dyshim i braktisur pas dy vjetësh nga A. Stojanovski, i cili i rikthehet hipotezës së parë, të mbrojtur me këmbëngulje nga T. Tomovski⁴⁴. Një mendim origjinal lidhur me kalanë e Koxhaxhikut ka dhënë V. Bitrakova. Sipas saj, në këtë kala ekzistojnë mbeturinat e fortifikimeve ilire, me mure të ndërtuara me gurë të punuar kënddrejtë, pa material lidhës, prandaj ajo sheh këtu një aglomeracion urban të periudhës së halshatit ilir, madje mendon se këtu duhet kërkuar një nga tre qytetet peneste të përmendura nga burimet antike në luftën III iliro-romake (169-168 para Kr.), ndërsa fortifikimi mesjetar është ngritur më vonë⁴⁵. Në vitet e fundit në diskutimin e këtij problemi, është përfshirë edhe studiuesi K.

A. “Bunguri, Vrojtme arkeologjike në krahinën e Dibrës së Madhe”, Simpoziumi *Dibra dhe etnokultura e saj*, Dibër, 1993 (aktet e simpoziumit); M. Hysa, “Sfetigradi si pikë strategjike, si lokacion, si konfiguracion dhe si arenë e luftës”, Simpoziumi *Skënderbeu dhe Dibra* (Dibër 2 mars 2003), Shkup, 2005, f. 103-117, sidomos f. 107-111; M. Bislimi, *art. i cit.*, f.164-172; Q. Lleshi, “Përshkrime dhe konstatime mbi Sfetigradin, nga burime historike dhe gjurmime në terren”, Simpoziumi *Skënderbeu dhe Dibra* (Dibër, 2 mars 2003), Shkup, 2005, f. 195-2002.

⁴³ S. Gopçeviç, *Das Fürstentum Albanien*, Berlin: 1914, f.269-270; Po ai, *Geschichte von Montenegro und Albanien*, Gotha: 1914, f. 72; I.S. Jastrebov, *Staraja Srbija i Albania*, Spomenik SK, XLI, Beograd: 1904, f.133-136; A. M. Selišceviç, *Slavianskoe Naselenje v' Albanie*, Sofie: 1931, f.127-128; S. Antolak, *art. i cit.*, f. 47-72.

⁴⁴ G. Palikruševa - A. Stojanovski, “Debarska oblast u shezdesetim godinama XV veka (na osnovu jednog savremenog turskog izvora)”, Simpozijum o Skënderbegu (9-12 maj 1968), Prishtina, 1969, f. 185-186; A. Stojanovski, “Tvrdinata i naselbata Kodzadzik vo XV i XVI vek”, *Bigorski naučno-kulturni sobori*, I, Naučen sobir, (22-23.X.1971) Gostivar: 1972, f. 205-209. Cituar sipas S. Antolak, *art. i cit.*, f. 50-51, shën. 14-15.

⁴⁵ V. Bitrakova-Groždanova, *Prilog kod antičkata na Debarskijot kraj*, Spisanje na Sojuzot na družvata na istoričarite na Republika Makedonija, Skopje: 1966, f.199. Megjithatë ajo nuk ilustron këtë mendim interesant me dokumentacionin e nevojshëm grafik apo fotografik. Ndryshe prej saj, M. Murra është shprehur për mundësinë e lokalizimit në këtë kala të kështjellës Stefaniakon të ndërtuar në kohën e Justinianit. Shih: M. Murra, *art. i cit.*, f.133.

Biçoku, sipas të cilit kalaja e Sfetigradit duhet lokalizuar në kalanë që ndodhet në shpatet e malit Dervenik afër Demir Hisarit në Sopotnicë, pranë rrugës që lidh Manastirin me Prilepin⁴⁶.

Çdo hipotezë përmban në vetvete edhe anët e dobëta të saj. Pika më e dobët për të dyja hipotezat është mungesa e gërmimeve arkeologjike. Dobësia themelore e hipotezës së dytë, është mosnjohja e mirë e terrenit apo injorimi i njohjes së arritur nga të tjerët. Më poshtë do të përpiqemi të risjellim në kujtesë disa nga argumentet që sipas mendimit tonë mbështesin hipotezën e parë, d.m.th lokalizimin e Sfetigradit në kalanë e Koxhaxhikut.

1. Pozita gjeo-strategjike e kalasë së Koxhaxhikut në mbrojtje të rrugës së Drinit ose rrugës Ohër-Dibër. Nga sipërfaqja e saj, njeriu nuk ngopet duke vështruar atë pamje magjepsë të pjesës veriore të luginës së Drinit të Zi. Prej aty shihet kështjella e Modricës në perëndim dhe i gjithë vargu kodrinor në krahun e majtë të Drinit të Zi, ndërsa mund të kontrollohen lehtësisht lëvizjet në krahun e djathtë të këtij lumi, nga kalonte dhe rruga që e lidhte këtë kala me Dibrën e Epërme (Oranikun). Në funksion të pikëpamjes sonë, duhet të kujtojmë se lugina e Drinit të Zi është arteria e vetme natyrore e komunikimit ekonomik e kulturor midis pellgut të Dibrës dhe atij të Ohrit, duke filluar që nga prehistoria e këndeje⁴⁷. Në periudhën romake, rruga e Drinit të Zi bashkonte dy magistralet më të rëndësishme transballkanike: rrugën Egnatia në jug (pellgu i Ohrit) dhe atë Lissus - Naissus në veri (pellgu i Kukësit). Ajo në tradicionin

⁴⁶ Kasem Biçoku, "Lufta e shqiptarëve për mbrojtjen e Sopotnicës (Sfetigradit) gjatë verës 1448", *Historia e Shqipërisë*, I, Tiranë: "Toena", 2002, f.410 - 411; Po ai, "Dibra dhe Koxhaxhiku në kohën e Skënderbeut", *Studime historike*, 1-2, 2003, f. 26-29, veçanërisht f. 27; Po ai, "Dibra në kohën e Skënderbeut", Simpoziumi *Skënderbeu dhe Dibra* (2 mars 2003), Shkup, 2005, f. 68; Po ai, "Shtrirja lindore e zotërimeve të Kastriotëve", Konferenca shkencore ndërkombëtare *Skënderbeu dhe Evropa* (9-10 dhjetor 2005), Tiranë, 2006, f. 78; Po ai, "Shtrirja lindore e zotërimeve të Kastriotëve", revista *Albanica*, nr. 62, nëntor 2006, f. 81.

⁴⁷ Në neolitin e hershëm ky komunikim dokumentohet nga analogjitë kulturore midis kulturës Burim I (Dibër) dhe kulturës bashkëkohëse të pellgut të Ohrit, gjegjësisht të zbuluara në Dolno Trnovo dhe Zlastrana. Shih: F.Prendi-Zh.Andrea, "Të dhëna të reja mbi neolitin në Shqipëri", *Iliria*, 1981, 2, f.16-19; P. Kuzman, *Dolno-Trnovo-Ranoneolitsko naselba*, Archeološki pregled, 1987, Ljubljana: 1989, f. 38-39; Në neolitin e mesëm këto kontakte pasqyrohen në ngjashmëritë midis kulturës Topojan I (Dibër) dhe asaj Ustie na Drim (Strugë). Shih P. Kuzman. *Zlastrana Sredorece, Naselba od postroriot neolit*, Archeološki pregled, 1988, Ljubljana: 1990, f. 72-74; A. Bunguri, "Vendbanimi neolitik i Topojanit", *Iliria* 1991, 1-2, f. 17, tab. V, 18-19. Në eneolit kjo rrugë dokumentohet nga paralelet kulturore Gradec (Peshkopi) - Kutlina (Ohër) Shih: P. Kuzman, "Kutlina", *Macedoniae Acta Archaeologica*, nr.14, 1993-1994, Skopje, 1996, f. 9-23; M. Korkuti, *Neolithikum und Kalkolithikum in Albanien*, Mainz am Rhein, 1995, f. 239-242, tab.109, 110.

popullor njihet me emrin “*rruga e karvaneve*“ ose “*udha e madhe*”⁴⁸. Duke qenë degëzimi verior i Egnatias antike ose “*rrugës mbretërore*“ në mesjetë, dhe i vetmi korridor komunikimi me Ohrin nga jugu, rruga e Drinit të Zi ishte mjaft e rëndësishme dhe kontrolli i saj përcaktues, veçanërisht në raste luftrash e veprimesh ushtarake. Ajo është shumë më e shkurtër dhe më strategjike se sa rruga e Vardarit dhe ajo e Radikës. Gjurmë të qarta të një rruge karrosh gjenden në rrëzën jugore të kalasë së Koxhaxhikut si dhe në anën lindore të varoshit të saj (*fig. 18*), ndërkohë që gjurmë të kësaj rruge mesjetare kemi ndeshur kohët e fundit në pjesën lindore të qytetit të sotëm të Dibrës, në segmentin që lidhte vendbanimin mesjetar tek lagjia “*Kodra e Beglerëve*” në veri me Urën e Gorencës mbi Radikë në jug⁴⁹.

2. Lokalizimin e qytetit të Sfetigradit në Dibrën e Sipërme e ka bërë vetë Barleti, i cili e thotë qartë se “*Ky qytet (Sfetigradi) ndodhej në Dibër të Sipërme, pranë kufirit të mbretërisë, si fole shqiponjash në një mal të lartë...i dukshëm nga të gjitha anët dhe i barabartë pothuaj me Stelushin*”⁵⁰. Meqenëse sipas Barletit kalaja e Sfetigradit gjendej në Dibër të Epërme⁵¹, ajo nuk duhet dhe nuk mund të kërkohet jashtë kësaj krahine, kështu që propozimi i bërë për në Sopotnicë, midis Manastirit dhe Prilepit, nuk gjen mbështetjen e duhur. Përpjekja për zgjerimin e kufijve të Dibrës mesjetare deri në këto hapësira⁵², është e paargumentuar dhe jo bindëse. Gjithashtu, autori i hipotezës së Sopotnicës nuk thotë në se në kalanë e Demir Hisarit (Sopotnicë) janë gjetur ose jo depozitime kulturore të shek. XIV-XV pas Kr., të cilat, përkundrazi janë të pranishme në kalanë e Koxhaxhikut (Sfetigrad). Po kështu, kështjella e Sopotnicës (Demir Hisar), e propozuar si vendlokalizimi i mundshëm i Sfetigradit është shumë larg prej këndeje dhe kontrollon “*rrugët ndërkrainore*

⁴⁸ I. Kaca, *Rrugët e vjetra të Dibrës*, Tiranë: 2003, f.16.

⁴⁹ A. Bunguri, *Shënime arkeologjike nga Dibra e Madhe* (ditar i dt.3 maj 2003), Arkivi i Institutit Arkeologjik. Ura e Gorencës, e rindërtuar në shek. XIX mbi gjurmët e një ure të periudhës romake e asaj mesjetare, është shkatëruar nga ndërtimi i HC të Dibrës në vitin 1964.

⁵⁰ M. Barleti, *vep. e përm.*, f.77-78.

⁵¹ Një nga mospërputhjet që gjen S. Antolak, në njoftimet rigorozisht të sakta të Barletit, për të kundërshtuar barazimin Koxhaxhik = Sfetigrad, është fakti se Barleti në një rast të vetëm, shkruan se “*Sfetigradi është në Dibër të Poshtme*”⁵¹, pasi ka thënë më parë disa herë se “*Sfetigradi gjendet në Dibër të Epërme*”. Shih: S. Antolak, *art. i cit.*, f. 55 shën. 51. Unë bashkohem me mendimin e prof. H. Ceka, shprehur që në vitin 1952 se kjo thënie e tij, duhet marrë vetëm si një lapsus në mos është gabim shtypi, qoftë edhe për rrallësinë e përdorimit.

Shih: H. Ceka, *Vërejtje mbi disa të dhana...*, f. 29.

⁵² K. Biçoku, “*Dibra dhe Koxhaxhiku ...*”, f. 11-23.

që lidhnin luginën e Vardarit me rajonet e Prilepit dhe Manastirit, me viset shqiptare në perëndim të tyre“⁵³ dhe jo vian e Drinit.

3. Pozita topografike e kalasë së Koxhaxhikut përputhet plotësisht me përshkrimin e Barletit mbi qytetin e Sfetigradit, aq sa ngjan si fotokopje e tij. Ai e cilëson këtë qytet si “vend fort i mbrojtur dhe gati i paafrueshëm”,⁵⁴ dhe tregon se “...vendi atje ishte aq i pjerrët, sa s’ të zinte këmba dhe gjëkundi e s’kishte ku të mbaheshe, veçse me ndonjë litar të fortë”⁵⁵, dhe se: “rreth murevet s’kishte veçse një rryp shumë të ngushtë që ishte shesh, kurse pjesa tjetër e malit, që vinte menjëherë, ishte fund e krye një rrëpirë e hatashme”.⁵⁶ Ai shkruan se “Qyteti (i Sfetigradit) ishte malor e i ndërtuar në majë të një shkëmbi shumë të lartë, pa asnjë burim uji përbrenda, por edhe pa ndonjë lum afër për ta përdorur. Kishte vetëm një pus brenda, të hapur e të ndërtuar në mes të qytetit, nga kujdesi i lashtë i popullit për dobi vetjake e të njerëzve dhe sidomos për nevojat e luftës... Roja e gjitha përbëhej nga ushtarë dibranë”⁵⁷. Sipas Barletit kështjella e Sfetigradit (Koxhaxhikut) ka pasur madhësinë e kështjellës së Stelushit⁵⁸, si dhe një pozitë topografike krejt të ngjashme me të, gjë që është konfirmuar nga gërmimet arkeologjike⁵⁹. Përkundrazi, lokacioni i ri i propozuar, gjegjësisht kështjella e Sopotnicës (Demir Hisari) është më e madhe se ajo e Koxhaxhikut dhe e Stelushit⁶⁰. Gjithashtu Sopotnica nuk i afrohet përshkrimit topografik të Sfetigradit të dhënë saktësisht nga Barleti, pa

⁵³ Po ai, “Lufta e shqiptarëve për mbrojtjen e Sfetigradit...”, *Historia e Shqipërisë*, vol. I, Tiranë: “Toena”, 2002, f. 410.

⁵⁴ M. Barleti, *vep. e përm.*, VI, f.35.

⁵⁵ *Po aty*, V, f.198.

⁵⁶ *Po aty*, VI, f. 237.

⁵⁷ *Po aty*, V, f.220. Të gjithë ata që e njohin terrenin, e dinë se Drini i Zi është rreth një orë larg kalasë së Koxhaxhikut, dmth jo aq pranë sa për tu shfrytëzuar nga banorët e kalasë dhe të varoshit. Kjo pozitë përputhet me përshkrimin që Ashik pashë Zadeja bën për kalanë e Koxhaxhikut. Shih: K. Frashëri, *Skënderbeu*, Tiranë 2002, f. 158.

⁵⁸ M.Barleti, *Historia e Skënderbeut*, I, 1964, f. 77: “Edhe ky qytet, megjithëse nga madhësia nuk mund të lavdërohet, por nga mbrojtja natyrore e vendit,... me plot të drejt mund ta ngresh në qiell : është një mal në fushat e Matit, i lartë në mes të një lugine të bukur, si t’ish vënë atje me qëllim. Vetë qafa e këtij mali, e rrethueme për bukuri me mrre, formon këtë qytezë”.

⁵⁹ Kalaja e Stelushit ndodhet në një kreshtë shkëmbore me lartësi mbidetare 1225m, në fshatin Qafë-Murrë, në kontroll të rrugës Dibër-Mat. Shih: S. Anamali, “Stelushi, qytet i Skënderbeut ...”, f. 105-110.

⁶⁰ K. Biçoku, “Shtirirja lindore ...”, Konferenca shkencore ndërkombëtare *Skënderbeu dhe Evropa (9-10 dhjetor 2005)*, Tiranë, 2006, f. 78. Perimetri i mureve të Sopotnicës është 280 m, diametrat e “akropolit”: ai L-P - 98 m dhe ai V-J - 82 m. Shih K. Biçoku, “Në Sfetigradin e Skënderbeut”, *Gazeta Tema*, 11 nëntor 2005, f. 14-15.

folur këtu për largësinë mjaft të madhe të saj nga via e Drinit dhe fortesa e Modricës.

4. Skema topografike dhe planimetrike e kalasë së Koxhaxhikut është krejt e ngjashme me kala të tjera të pranuar mirëfilli si të ndërtuara apo të rifortifikuara nga Skënderbeu, siç janë kalaja e Stelushit në Qafë-Murrë, kalaja e Gurit të Bardhë (Mat), kalaja e Daules (Kurbini), kalaja e Petrelës (Tiranë), kalaja e Krujës⁶¹ etj. Është e tepërt të themi se të gjitha kalatë e mësipërme të Skënderbeut gjenden në rajone malore, në mbrojtje të rrugëve të brendshme strategjike nga lëviznin ushtritë. Pjesa kryesore e këtyre kalave dhe njëherësh qyteteve mesjetarë, përbëhej nga zona e fortifikuar ose çitadela, që gjendet në majën e kodrës dhe luan rolin e “akropolit” dhe varoshi ose qyteti jashtë mureve rrethuese, ku gjenden godinat e banimit dhe ato shoqërore dhe zejtare. Çitadela kishte përmasa modeste, me madhësi nga 0.1 - 0.2 ha. Si element integral ajo kishte gjithnjë pusin apo sterën e ujit, zakonisht të furnizuar me tubacion qyngjesh qeramike. Një parim i tillë ishte në përputhje me artin ushtarak të Skënderbeut, i cili kurrë nuk i përqëndronte të gjitha forcat brenda mureve rrethuese. Në kala, ai linte një garnizon të vogël (në rastin tonë 2000 ushtarë nën komandën e Pjetër Perlatit)⁶², ndërsa me forcat kryesore i ngrinte pusi armikut, duke e goditur atë në befasi, natën, në fushim ose gjatë marshimit, dhe duke e asgjësuar atë pjesë-pjesë. Për këtë arsye, nuk ishte e nevojshme dhe e domosdoshme që kalatë e Skënderbeut të kishin patjetër sipërfaqe të madhe.

5. Distancat e dhëna nga Barleti të qyteteve-kështjellë të Skënderbeut në raport me Krujën, si kryeqendër e shtetit të tij, mbështesin hipotezën tonë. Më poshtë po japim një tabelë përmbledhëse të këtyre distancave:

Qytetet-kështjellë	Distanca në “hapa romakë”	Distanca në km
Krujë - Petrelë	25.000 hapa	afër 37 km (37.037,5 m)
Krujë - Petralbë (Guri i Bardhë)	30.000 hapa	„ 44 km (44.445 m)
Krujë - Stelush	50.000 hapa	„ 74 km (74.075 m)
Krujë- Dibër e Poshtme	80.000 hapa	„ 118 km (118.520 m)
Krujë - Dibër e Epërme	70.000 hapa	„ 103 km (103.705 m)
Krujë - Oranik (Rahonik)	60.000 hapa	„ 88 km (88.890 m)
Krujë - Sfetigrad	57.600 hapa ose 480 stade	„ 85 km (85.334.40 m) ⁶³

⁶¹ S. Anamali, “Stelushi, qytet i Skënderbeut..”, f.108; Gj. Saraçi, “Kalaja e fshehtë e Skënderbeut...”, f. 205-206.

⁶² M.Barleti, *Historia e Skënderbeut*, 1964, IV, f.192.

⁶³ *Po aty*, I, f.77, IV, f.184. Hapi është njësi matëse gjatësie tek romakët e barabartë me 5 këmbë ose 1.4815 m. Stadi është njësi matëse gjatësie afërsisht 180 m. Stadi i Atikës ishte baraz me 177.6 m, ai i Egjiptit 184.85 m etj. Shih : *Fjalorth i termave, Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, Tiranë, 1965, f. 511. Konvertimi në km

(fig. 33- Hartë e disa kalave të Skënderbeut)

Sipas llogaritjeve, rezulton se distanca Sfetigrad - Krujë është rreth 57.600 hapa romakë ose afro 85 km (85.334.40 m), aq sa ç'është afërsisht distanca Koxhaxhik-Krujë në linjën Koxhaxhik- Dibër-Bulqizë(Vajkal)-Guri i Bardhë-Krujë. Ndërkaq, distanca Sopotnicë-Krujë është rreth 200 km ose afër 140.000 hapa romak. Është vështirë të besohet një mospërputhje kaq e madhe në të dhënat mjaft të sakta të Barletit.

6. Një e dhënë tjetër në këtë drejtim është fqinjësia gjeografike e Mokrës, Dibrës së Epërme, Modriçit dhe Sfetigradit. Barleti vë në dukje se Skënderbeu i kishte vendosur “*jo larg Sfetigradit dhe malit Mokra, 2000 ushtarë trima për t'ia mbyllur shtigjet armikut*”. Gjithashtu gjatë përshkrimit të ekspeditës pushtuese të Sinan Pashës, Barleti tregon se “*ai ... ishte drejtuar për në fushë të Pollogut, drejt Mokrës. Që këndeje ai e kishte pastaj rrugën të hapur për në Dibër të Sipërme dhe për në Modrisë*”⁶⁴. Meqenëse tri nga toponimet e mësipërme, përkatësisht Pollogu, Dibra e Epërme dhe Modrica janë vende fqinje dhe të lokalizuara me siguri, atëherë, me këto njoftime vërtetohet fqinjësia ose afërsia gjeografike e tyre (Pollogut, Mokrës dhe Modriçës) me Sfetigradin. Lokalizimin e Mokrës e jep qartë Barleti kur shkruan se : “*Fusha (e Pollogut) kufizohet nga njëra anë prej malit tonë të Mokrës, nga ana tjetër prej qytetit të turqvet, që ata e quajnë Shkup*”⁶⁵. Ky pasazh provon se mali Mokra i Skënderbeut gjendet me të vërtetë në afërsi të Koxhaxhikut, në zonën malore midis Dibrës, Pollogut dhe Kërçovës⁶⁶ dhe jo në Mokër të Pogradecit, siç ka qenë menduar më parë⁶⁷. Sopotnica jo vetëm që nuk ka fqinjësi gjeografike me viset e mësipërme, por është shumë larg tyre.

është bërë mbi bazën e hapit romak dhe të stadi të Atikës. Kjo distancë midis Sfetigradit dhe Krujës konfirmohet edhe nga burime të tjera historike të kohës. Kështu sipas D. Frangut, *Qyteti i Sfetigradit ishte 58 milje larg Krujës*, shih: Dh. Frangu, “Veprat e lavdishme të Skënderbeut”, Tiranë, 2007, f. 98. Duke ditur se 1 milje është e barabartë me 1000 hapa romakë ose 1481.5m, rezulton se kjo distancë është rreth 85 km (85.927m). Prof. H. Ceka me të drejtë mendon se distanca prej 6000 hapash, e dhënë për Oranikun (Rahonikun) duhet të jetë gabim shtypi, dhe e korrigjon atë në 60.000 hapa. Shih: H. Ceka, *Vërejtje mbi disa të dhana...*, f. 28- 29.

⁶⁴ M. Barleti *vep. e përm.*, IX, f. 382.

⁶⁵ *Po aty*, VII, 302.

⁶⁶ H. Sadiku, *art. i cit.*, f. 454; H. Ndreu, *vep. e përm.*, f. 53 - 66; M. Bislimi, *art. i cit.*, f.158, shën. 50.

⁶⁷ Dh.S. Shuteriqi, “Aranitët”, *Studime historike*, 1965, 4, f. 3-35; *Studime për epokën e Skënderbeut*, II, Tiranë 1989, f. 94, harta f. 118.; *Vizantijski izvori na istoriju naroda Jugoslavije III*, poesbna izdanja Vizantoloskog Instituta, SAN 10, Beograd, 1966, f. 269, shën. 44, f. 318, 363, 394, shën.55. Cituar sipas S. Antolak, *art. i cit.*, f.57, citimi nr.64.

7. Varreza e madhe pranë kalasë së Koxhaxhikut, megjithëse ende e pastudiuar në pikëpamje arkeologjike, shtron mundësinë e lidhjes qoftë edhe hipotetike të saj me luftimet e ashpra të zhvilluara këtu gjatë rezistencës së fortë për mbrojtjen e këtij qyteti në verën e vitit 1448 (maj-qershor) apo rimarjen e tij nga Skënderbeu në vjeshtën e po atij viti (22 shtator-26 tetor 1448). Barleti përshkruan me hollësi të gjitha fazat e betejës së gjatë dhe mjaft të përgjakshme për mbrojtjen e Sfetigradit, që nga luftimet natën brenda kampit armik⁶⁸ e deri në luftimet trup me trup në muret e qytetit⁶⁹, i cili siç dihet u pushtua me tradhëti, duke helmuar pusin e ujit të qytetit⁷⁰. Sipas Barletit, në të dy betejat për Sfetigradin, në një interval kohor prej 5-6 muajsh (maj-tetor 1448), u vranë nga të dy kampet gjithsej 2272 ushtarë e kapedanë dhe u plagosën rreth 1000 të tjerë⁷¹.

8. Vetë emri Koxhaxhik i fshatit dhe i kalasë eponyme, është një tregues që të shtyn të besosh ne barazimin Koxhaxhik-Sfetigrad. Sipas dëshmimeve të kronistit Ashik-pashë Zadeja, rezistenca për mbrojtjen e Koxhaxhikut (Sfetigradit) ka zgjatur mbi dy muaj, të cilat përputhen me tregimin e Barletit⁷².

⁶⁸ M. Barleti shkruan se “atëhere lufta u bë kritike dhe vendi u mbulua me kufoma e u skuq nga gjaku i shumë. Kastrioti solli e vuri përpara dyfekët, agrepat dhe gjithë togun e shigjetarëvet, prandaj, duke i pritur kështu armiqtë që po turrshin, u shkaktoi që në sulmin e parë një kërdi aq të madhe, saj që ata që mbetën shtang e të ngrirë nga frika, të cilën ua bënte më të madhe nata, me dyshim në zemër, të vazhdonin më apo të ktheheshin prapa... Turqit qëndruan atje gjersa zbardhëlleu agimi dhe i bëri të shihnin kërdinë e shokëvet dhe t’i numëronin me lot në sy kufomat e tyre”. Po ai, *vep. e përm.*, V, f.208.

⁶⁹ M.Barleti, *Historia e Skënderbeut...*, V, f.198. “Nga kjo anë muret ishin të paprishura dhe, përveç shkallëve, s’dukej të kish ndonjë mjet tjetër për ta shtënë qytetin në dorë...Shumë rëzoheshin e përplaseshin në dhe nga pesha e, duke u rrokullisur bashkë me shkallët që thyheshin nga pesha e atyre që ngjiteshin... përplaseshin për shkak të gishtrinjëve që ua prisnin dhe të duarvet që s’u vlenin më për tu mbajtur. Por mbi të gjitha lufta bëhej me gurë, që lëshoheshin së sipërmi e binin me një zhurmë të hatashme, duke u shkaktuar kështu pa dallim kërdi të njëjtë.. luftëtarëvet... sadoqë kudo binin pa numër, prapsëprapi ngjiteshin të tjerë jo më të paktë.”, që “duke u lëshuar përmes kufomavet dhe gjakut të të vranëvet, që dergjeshin përdhe,...po përpiqeshin të rrëmbenin forcomat e murevet”.

⁷⁰ Po aty, V, 220.

⁷¹ Në rrethimin e Sfetigradit në qershor 1448 komandanti i fushatës Feriz pasha kishte në dispozicion 12.000 kalorës dhe 6000 këmbësorë. Në këtë betejë nga forcat turke u vranë rreth 2000 ushtarë dhe u plagosën më tepër se 500, ndërsa nga forcat mbrojtëse të Skënderbeut 42 ushtarë. Ndërsa gjatë përpjekjes për rimarrjen e kësaj kalaje strategjike, në shtator-tetor 1448, Skënderbeu humbi rreth 230 ushtarë dhe më se 500 u plagosën. M. Barleti, *vep. e përm.*, V, f.208; VI, f. 233, 238, 243.

⁷² K. Frashëri, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu*, Tiranë: 2002, f. 158; M. Barleti, *vep. e përm.*, VI, f. 231.

Që këndej duket se ka mbetur edhe emri Koxhaxhik, i formuar nga fjalët turqisht “*koxha*” + “*xhink*”, që në shqip ka kuptimin “*luftë e madhe*”⁷³. Një arsye më shumë që e bën këtë të besueshme është edhe fakti se toponimi turk “*Koxhaxhik*” në defteret osmane shfaqet vetëm prej vitit 1453⁷⁴, dmth 5 vjet pas pushtimit të tij nga turqit dhe se nga viti 1466 Koxhaxhiku përmendet si „qytet“ dhe si „fshat“, me garnizon dhe banorë, me një status të privilegjuar⁷⁵. Ky emër ka ardhur deri më sot jo vetëm nga regjistrat kadastral osman dhe kujtesa popullore, por edhe nga jeniçerët dhe kolonët turq të vendosur me urdhër të sulltanit, në kala dhe përreth saj pas pushtimit të Sfetigradit⁷⁶. Është kjo arsyeja që pranë kalasë së Koxhaxhikut sot gjenden 6 fshatra turqishtfolës, që janë : *Pralanik, Breshtan, Novak, Elefc, Koxhaxhik dhe Dollgash*. Ky fakt sigurisht mbështet lidhjen Koxhaxhik-Sfetigrad. Vetiu rrjedh pyetja se përse nuk kemi popullsi turqishtfolëse përreth Sopotnicës, kur burimet turke tregojnë për vendosjen e këtyre kolonëve pas marrjes së Sfetigradit ?

9. Një nga “*pikat e dobëta*” të barazimit Koxhaxhik-Sfetigrad, të nënvizuar nga S. Antolak, është fakti se: në burimet turke përmendet gjithmonë Koxhaxhiku, ndërsa në ato perëndimore Sfetigradi. Gjithashtu ai vëren një mospërputhje kronologjike të kohës së pushtimit të Koxhaxhikut (ndërmjet 19.03.1447 - 07.03.1448) dhe të Sfetigradit (fundi i korrikut ose fillimi i gushtit 1448). Sipas kronikave turke, pushtimi i kështjellës së Koxhaxhikut është kryer pas vitit 851 Hixhri sipas kalendarit osman, ose pas vitit 1447 sipas kalendarit latin gregorian⁷⁷. Mospërputhja e konstatuar rrjedh nga fakti i mospërputhjes dymujore të kalendarit hënor osman dhe atij latin gregorian, fakt i vënë në dukje më parë edhe nga studiuesi M. Bislimi⁷⁸.

Po kështu theksohet fakti se burimet turke nuk e përshkruajnë fare pozitën e Koxhaxhikut, ndërsa ato latine e përshkruajnë hollësisht pozitën e Sfetigradit⁷⁹. Unë besoj se kjo ka ndodhur ngaqë osmanët duhet ta kanë njohur mirë pozitën e Koxhaxhikut(Sfetigradit). Me këtë rast dua të shtroj pyetjen: Cila palë ishte më e interesuar dhe më mirinformuar për luftërat që zhvilloheshin në Shqipëri në këtë kohë, pala që bënte luftën, pra Turqia, apo pala neutrale perëndimore, që priste rezultatin e tyre për të orientuar politikat e

⁷³ S. Antolak, sjell mendimin e B. Rusiq, sipas të cilit emri Koxhaxhik rrjedh nga emri “*Koxha*., - *plak*” dhe që i vendosur në kodrën shkëmbore në veriperëndim të fshatit, i ngjan “*plakut*”(gurit të kufirit) dhe të prof. dr. Skënder Riza, sipas të cilit ky emër ka kuptimin “*qytet i vjetër (Starigrad)*”. Shih : S. Antolak, *art. i cit.* f. 52, shën. 33-35.

⁷⁴ S. Antolak, *art. i cit.*, f. 53, shën. 36.

⁷⁵ *Po aty*.

⁷⁶ M. Barleti, *Historia e Skënderbeut...*, V, f.227.

⁷⁷ M. Bislimi, *art. i cit.*, f. 165 dhe literatura e cituar aty.

⁷⁸ *Po aty*, f. 166.

⁷⁹ S. Antolak, *art. i cit.*, f. 66-67.

saj ? Dhe më tej, cilët kronikanë mund të shkruanin më saktë ngjarjet, ato që ishin në terren, shumë afër vendit të ngjarjes, në rastin tonë ato turq, apo kronistët perëndimorë, që shkruanin nga Venediku, Roma apo Napoli, që nuk e njihnin terrenin dhe që informoheshin me vonesë mbi këto ngjarje ?! Dhe më në fund, po sjell këtu edhe dyshimin e autorit të hipotezës së kundërt, që dëshmon për paqartësinë dhe eklektizmin e propozimit të tij : “ *Nuk duhet përjashtuar mundësia që në fillim me emrin e Koxhaxhikut osmanët të kenë emërtuar përkohësisht edhe vetë kështjellën e Sopotnicës* “⁸⁰.

Gjithashtu konsiderohet si “*pikë e dobët*“ ekzistenca e depozitimeve kulturore antike dhe paramesjetare në kalanë e Koxhaxhikut, të vëna në dukje nga B. Rusiq⁸¹, V. Bitrakova⁸² dhe I. Mikulčić⁸³. Në të vërtetë, ky fakt flet në të mirë të hipotezës sonë, pasi edhe disa nga kalatë e përdorura apo të fortifikuara nga Skënderbeu, si ajo e Stelushit, Krujës etj kanë depozitime më të hershme kulturore, sa duket edhe në sajë të pozitave dominante të tyre. Kështu kalaja e Stelushit, rezulton se “ *ka qenë një vendbanim i lashtë ilir “ i banuar që në periudhën e hershme të hekurit, “ dhe si i tillë ka vazhduar deri në kohën e vonë antike* “⁸⁴, ndërsa depozitimet më të hershme të kalasë së Krujës i takojnë shek. III-II para Kr⁸⁵.

10. Barleti e quan Sfetigradin “*sancta civitas*” dmth “*qytet i shenjtë*”⁸⁶, emërtim i përkthyer në bullgarishten mesjetare në “*Svetigrad*”. Nga rëndësia e dikurshme e këtij qyteti dhe kisha e Shën Mërisë, që e vishnin atë me një predikativ të tillë, nuk ka mbetur thujt asgjë, përveç një trakti muri, që ndoshta mund t’i takojë kësaj kishe. Por përveç kujtimit mbi shenjtërinë e këtij qyteti, dhe besimit mbi cilësitë e shenjta të kësaj kalaje, të ruajtur në memorien popullore, ne gjetëm edhe një fakt interesant. Është fjala për veshjen me attribute religjioze të njërit nga dy dybeqet e barutit të përmendura më lart, ndoshta si reminishencë e kujtimit shenjtëruës të kësaj kishe. Kulti i saj duket se ka arritur deri në ditët tona i transformuar në një ritual ofertash me përmbajtje kishtarë. Ky rit praktikohet në ditë të caktuara të vitit, kur besimtarët shkojnë dhe lënë aty monedha etj, duke shpresuar në shërimin e sëmundjeve të ndryshme, kërkimin e fatit në jetë etj. Është kjo një e dhënë e tërthortë, që na shtyn të besojmë, se me të vërtetë, kalaja e Koxhaxhikut përputhet me funksionin religjioz të Sfetigradit si “*sancta civitas*”. Ndërkaq, emri “*Sveta*” i

⁸⁰ K. Biçoku, “Lufta e shqiptarëve për mbrojtjen e Sopotnicës ...”, f. 411.

⁸¹ Sipas B. Rusiq, në vitin 1952, në këtë kala janë gjetur edhe mbishkrime nga koha antike. Cituar sipas S. Antolak, *art. i cit.*, f. 59, shën. 78.

⁸² V. Bitrakova, “Prilog...”, f. 199.

⁸³ И. Микүльчич, *Антички градови...*, f. 404.

⁸⁴ S. Anamali, “Stelushi...”, f. 106.

⁸⁵ D. Komata, “Të dhëna të reja arkeologjike ...”, 1, f. 222.

⁸⁶ M. Barleti, *Historia e Skënderbeut...*, I, f. 77.

fshatit fushor në veri të kështjellës së Sopotnicës, i konsideruar si mbetje toponimike e emrit Sfetigrad⁸⁷, nuk mjafton për të përligjur lokalizimin e propozuar. Ai duhet të jetë më shumë mbetje toponimike në sllavisht e kujtimit shenjtëruës të ndonjë kishe mesjetare, të cilat në këtë periudhë, kanë qenë të shumta e të kudondodhura.

11. Një e dhënë tjetër e rëndësishme në mbështetje të hipotezës sonë, është edhe ndërtimi nga Skënderbeu i fortesës së Modricës dhe korelacioni i saj me Sfetigradin. Ajo u ndërtua pas rënjes së Sfetigradit, për të kontrolluar të njëjtën vijë të mbrojtjes, atë të Drinit të Zi, që për Skënderbeun kishte një rëndësi strategjike⁸⁸. Përshkrimi i kësaj forteze nga Barleti është i gjallë dhe i plotë: *“Ishte një mal, banorët e quajné Modrisë, thikë e rrëpirë, i cili, për shkak të lartësisë së vetë, vështronte përpara tokat e turqve në një hapësirë të madhe. Atje ai vendosi të ngrinte një kështjellë, dhe ta mbushte me luftëtarë, të cilët, me krismën e përdredhoreve të lajmëronin kur të vinin armiqtë”*⁸⁹. Më poshtë ai shton se ndërtimi i kështjellës „filloi e mbaroi në qetësinë më të madhe, pa ngjarë gjë gjatë asaj kohe nga ana e armikut”⁹⁰.

Kjo fortesë ndodhet në majën e një kreshte të thiktë shkëmbore me lartësi 996 m, afër fshatit homonim, në krahun e majtë të Drinit të Zi dhe përroit të Modriçës⁹¹. E ngritur përballë kalasë së Koxhaxhikut, me të cilën ka komunikim pamor, fortësia ka një pozicion strategjik dhe kontrollon grykën e Drinit dhe rrugën Strugë-Dibër. (fig. 30. Pamje e fortesës së Modricës).

⁸⁷ K. Biçoku, “Shtrirja lindore ...”, f. 78; Po ai, “Në Sfetigradin e Skënderbeut”, f. 15. Ai duhet të jetë më shumë mbetje toponimike në sllavisht e kujtimit shenjtëruës të ndonjë kishe, të cilat në këtë periudhë, kanë qenë të shumta e të kudondodhura

⁸⁸ Duke treguar për lëvizjet e ushtrisë së Skënderbeut kundër kampit armik në Ohër, pas rënies së Sfetigradit, Barleti shkruan se: *“ai (Skënderbeu) në të ngrysur të asaj dite u nis me më shumë se 1000 kalorës për në Ohër, duke e hequr ushtrinë me shumë kujdes përmes disa pyjeve dhe vendeve të papërshtatshme, për të mos u mbyllur nga armiku në mes të Sfetigradit dhe të rojeve të tij”* Shih : M. Barleti, *Historia e Skënderbeut*, IX, 383.

⁸⁹ M. Barleti, *Historia e Skënderbeut*, VII, f.293. Fortësia e Modricës është vizituar edhe nga H. Sharofi, i cili shkruan se : *“Skënderbeu për ti bërë ballë rrezikut që i shkaktoj humbja e Sfetigradit, themeloi dhe ndërtoi me të shpejtë fortesën e Modriçës, në krah të majtë të Drinit, ballë për ballë me Sfetigradin, që ishte në krah të djathtë të Drinit. Kjo fortesë e mbyllte grykën e Drinit dhe kontrollonte lëvizjet e ushtrisë turke e i lajmëronte kështjellat e tjera me anë të topit”*. H. Sharofi, *Historia e Dibrës*, f. 49, si dhe nga Jastrebov, Shih: I. S. Jastrebov, *Staraja Srbija i Albania...*, f. 125 etj.

⁹⁰ M. Barleti, *Historia e Skënderbeut*, VII, f.293. Ndërsa sipas H. Cekës *“në këtë mal Skënderbeu ndërton brenda 15 ditëve një kështjellë për tu pre hovin ushtrive turke”*. Shih : H. Ceka, *Vërejtje mbi disa të dhana...*, f. 26.

⁹¹ Në vizitën e kësaj forteze në tetor 1993 jam shoqëruar nga miqtë e mi nga qyteti i Dibrës, z. F. Cami dhe z. N. Tominaj, ndërsa në vizitën e dytë të vitit 2006 nga bashkëpunëtorët e shënuar në shënimin nr. 1, të cilët i falënderoj për ndihmën e tyre.

Fortesa ka mbrojtje të fortë natyrore, sipërfaqe të vogël rreth 300 m², perimetër 102 m, diametrin veri-jug 50 m dhe atë lindje-perëndim 45 m. (**fig.33. Skicë planimetricke e fortesës së Modriçës**). Ajo ka qenë e fortifikuar me mure, gjurmët e të cilin mund të ndiqen vetëm në anën lindore dhe atë verilindore, në një gjatësi prej 26 m. Trakti më mirë i ruajtur, me gjatësi 2 m, lartësi 0.80m dhe gjerësi 1.00 m gjendet në anën verilindore, pranë sterës. Muri është ndërtuar me gurë lumorë dhe të terrenit, të lidhur me llaç gëlqerorë, i përzier me rërë zalli të pasitur, cilësisht mjaft i dobët, gjë që ka ndikuar në mosruajtjen e linjës së murit, që ka mbushur hapësirat midis shkëmbinjëve natyrorë. (**fig. 31. Trakt i murit lindor**). Kjo veçori teknike tregon për ngutje në ndërtimin e saj (gëlqerja është përdorur menjëherë pas shuarjes), gjë që përputhet me burimet historike, sipas të cilave, kjo fortesë u ndërtua me nxitim nga Skënderbeu, pas rënies së Sfetigradit.

Në anën verilindore të fortesës u gjet një sterë uji në trajtë katërkëndëshe, me brinjë 1.80 x 2.50 m, thellësi të matshme 3.30 m dhe vëllim mbi 14,85 m³. (*dysHEMEJA e sterës është e zënë nga shembjet e gurëve dhe dherat*) (**fig.32. Pamje e sterës së ujit**). Gjerësia e mureve të sterës është 1.00m. Sipërfaqja e brendshme e saj është e suvatuar me llaç shamot, i bërë me pluhur tulle, shumë i fortë dhe i papërshkueshëm nga uji, që ka krijuar një shtresë të fortë në trajtë graniti, me ngjyrë të kuqërremtë. Në kontekst me sistemin fortifikues, kjo sterë është përgatitur me të gjithë kujdesin e mundshëm. Një gjë e tillë është e shpjegueshme, po të kujtojmë se kjo fortesë i vlente Skënderbeut kryesisht si pikë vrojtimi dhe se nevoja për ujë të pijshëm ishte e përhershme. Në këtë kështjellë, sipas burimeve historike, u instalua nga Skënderbeu për herë të parë sistemi i ndërlidhjes me top, ose siç e quan Barleti “*përdredhore*”⁹².

⁹² M. Barleti, *Historia e Skënderbeut*, VII, f.293; Edhe studiuesi M. Bislimi, thekson faktin se në këtë kala, “*Skënderbeu vendosi një garnizon me 400 ushtarë të zgjedhur nën komandën e Gjergj Strez Balshës... me detyrë vrojtimit dhe ruajtjen e kufirit*”, Shih : M. Bislimi, *art. i cit.*, f. 172-173. Barleti jep edhe distancat e fortesës së Modriçës si me kufirin turk (14.000 këmbë ose rreth 20 km (20.741 m), që pas pushtimit të Sfetigradit ishte afuar më në brendësi, ashtu edhe me Sfetigradin (30.000 këmbë) ose rreth 44 km (44.445 m), që në rrethanat e reja, përfshihej në territoret e pushtuara. Ne nuk e dimë saktësisht cila ka qenë vija e ndarjes së territoreve të lira dhe atyre të pushtuara në këtë rajon, por dimë se distanca prej 30.000 këmbësh ose afro 45 km midis Modriçës dhe Koxhaxhikut, nuk përputhet me distancën reale në terren. Megjithatë jemi të prirur ta konsiderojmë atë si një gabim të kopjimit apo të shtypit, pasi ky është vetëm një element i pasigurt në shumësinë e argumenteve që e mbështesin lokalizimin pikërisht këtu të fortesës së Modriçës. Pavarësisht se këto distanca nuk mund të jenë preçize, ato provojnë se Modriça është afër Sfetigradit (Koxhaxhikut) dhe se kjo fortesë u ndërtua pas rënies së tij, për të kontrolluar të njëjtën vijë të mbrojtjes, atë të Drinit të Zi, që për Skënderbeun kishte një rëndësi strategjike.

Më në fund po përmendim këtu disa të dhëna të sjella nga K. Biçoku, në artikullin e tij mbi Koxhaxhikun. I mbështetur në regjistrin kadastral të marsit 1467, ai pohon se *“trupat osmane kishin arritur të shtinin në dorë një numër kështjellash të Skënderbeut, që kontrollonin rrugët malore e të komunikimit të Krujës me viset në lindje të saj, si: Stelushin, Gurin e Bardhë, Modricën e Koxhaxhikun. Gjithashtu, sipas këtij regjistri, midis shqiptarëve dhe osmanëve janë bërë luftime të ashpra në tri krahina kryesore: në Krujë, Koxhaxhik dhe në Rekë. Luftimet e ashpra i kishin detyruar banorët e fshatrave pranë kështjellës së Krujës, Koxhaxhikut dhe të krahinës së Rekës, që të braktisnin vendbanimet e tyre.”* Ky regjistër ka shënuar *“në krahinën e Koxhaxhikut 15 fshatra krejt të braktisur dhe 34 fshatra me nga 1 - 5 familje”*⁹³.

Mendojmë se kjo braktisje dhe ky shpopullim masiv i rajonit janë rrjedhojë e drejtpërdrejtë e luftërave kundër pushtuesit të zhvilluara këtu para pushtimit të tij dhe hartimit të këtij regjistri kadastral, si dhe e reperkusioneve që osmanët ndërmorën kundër popullsisë së tij. Këto të dhëna vetëm e përforcojnë hipotezën e lokalizimit të qytetit mesjetar të Sfetigradit në kalanë e Koxhaxhikut.

Të dhënat e reja arkeologjike që publikohen për të parën herë, si dhe argumentet historikë të paraqitura më lart, në mbështetje të lokalizimit të qytetit të Sfetigradit në Koxhaxhik, shpresoj se do të ndihmojnë sadopak në sqarimin e këtij problemi të rëndësishëm të historisë sonë mesjetare. Me këtë rast duhet korrigjuar një pasaktësi jo e vogël në faqet e shtypit shkencor lidhur me kalanë e Koxhaxhikut. Kështu nuk qëndron pohimi i shkruar se: *“Pranë këtij fshati është një shkëmb i lartë që ka shërbyer si pikë vrojtimi. Thuhet se aty ka qenë kalaja...Në Koxhaxhik nuk ka gjurmë kështjelle të ndërtuar me gurë dhe as që mund të ngrihej një kështjellë e tillë në një lartësi aq të madhe. Në Koxhaxhik kështjella ka qenë prej druri”*⁹⁴.

Pavarësisht këtij pohimi aspak shkencor, kalaja e Koxhaxhikut është aty dhe ruan pjesë të sistemit të dikurshëm fortifikues, të ndërtuar me mure gurësh të lidhura me llaç gëlqeror, që mund të shihen nga kushdo që ka dëshirë të merret me studimin e kësaj kalaje. Identifikimi ose jo i saj me Sfetigradin, megjithëse për mua është jashtë çdo dyshimi, është një çështje dytësore dhe e diskutueshme midis studiuesve. E rëndësishme dhe e detyrueshme është paraqitja e saktë e monumentit, të cilit i referohemi.

Megjithëse është normale që studiuesit të mos kenë të njëjtin mendim për një problem të caktuar, duhet thënë se liria e mendimit është relative dhe lypset të jetë në koherencë të plotë me faktet arkeologjike dhe historike. Nuk mund të ketë liri absolute mendimi, pasi ndodh që për hir të lirisë për liri, të kalohet në voluntarizëm dhe subjektivizëm. Rruga më e mirë për t'i shpëtuar këtij rreziku

⁹³ K. Biçoku, “Dibra dhe Koxhaxhiku ...”, f. 24.

⁹⁴ Po aty, f. 27.

është bashkëpunimi midis studiuesve të historisë dhe atyre të arkeologjisë, veçanërisht kur është fjala për monumente të karakterit arkeologjiko-historik.

Sidoqoftë, fjalën e fundit për mbështetjen apo rrëzimin e hipotezës së mbrojtur prej nesh do ta thonë gërmimet e ardhshme arkeologjike. Por deri atëherë, në tekstin e ri të Historisë së Shqipërisë, duhen pasqyruar patjetër qartë të dy hipotezat lidhur me këtë problem, si ajo “e vjetra” e Koxhaxhikut, ashtu edhe ajo “e reja” e Sopotnicës, dhe jo të injorohet mendimi i kundërt, siç ka ndodhur në këtë rast⁹⁵.




Fig. 1. Pamje e përgjithshme e kalasë së Koxhaxhikut




Fig.2. Pamje e kalasë nga Breshtani (jugperëndimi)



Fig.3. Pamje nga jugu e kalasë



Fig. 4. Pamje nga veriu e kalasë


⁹⁵ Që lexuesi të mos marrë informacion të gjymtuar historik, do të ishte korrekte dhe objektive që në tekstin e Historisë së Shqipërisë të pasqyrohen qartë të dy hipotezat kryesore të lokalizimit të Sfetigradit, dhe jo të paraqitet si e instutucionalizuar dhe e mirëqenë vetëm njëra prej tyre, duke injoruar mendimin e kundërt. Shih: K.Biçoku, “Lufta e shqiptarëve për mbrojtjen e Sopotnicës ...”, f.410-411.



Fig. 5. Pamje e sheshit të kalasë



Fig. 7-8. Trakte të murit jugor të segmentit E



*Fig. 6. Skicë planimetricke e kalasë
Liasse Turkei XLV/c, karton 417*



*Fig.. 9. Muri I i jashtëm i kullës
(trakti C)*



Fig. 10. Muri II i jashtëm i kullës (trakti C)



Fig. 11. Trakt i murit F



Fig. 12. Trakt i murit D



Fig. 13. Vrimë skelerie në murin E



*Fig. 14. Trakt muri i një godine brenda
rrethimit (kishë?)*




Fig. 15. Pamje e dybekut nr. 1 të kalasë



Fig. 16. Pamje e varoshit nga kalaja



Fig. 17. Pamje e themeleve të një godine në varosh



Fig. 18- Traseja e rrugës së karrove në varosh



Fig. 19-20. Pamje e pjeshme e varrezës së poshtme





Fig. 22. Tab. II. frag. enësh mesjetare




Fig. 23. Tab. III. frag. enësh mesjetare



Fig. 24. Foto enësh të periudhës së bronzit të vonë



Fig. 25. Foto enësh të periudhës mesjetare



Fig. 26. Foto funde enësh mesjetare



Fig. 27. Foto vegjë enësh mesjetare



Fig. 28. Foto enësh të zbukuruara me teknika mesjetare



Fig. 29. Foto enësh të zbukuar me glazurë të bardhë




Fig. 30. Pamje e kreshtës së kështjellës së Modricës



Fig. 31. Trakt i murit lindor të kështjellës së Modricës



Fig. 32. Pamje e sterës së ujit të kështjellës së Modricës




Fig. 33. Skicë planimetrike e fortesës së Modricës




Fig. 34. Hartë e disa kalave të Skënderbeut

Summary

KOXHAXHIK'S CASTLE (DIBËR)

Koxhaxhik's castle lies at Zhupa area, between Dibra and Struga, in the western parts of FYROM. It was placed at a very rocking crest and in a very strategic favourable position, easy controlling the road through the Drini i Zi valley. This is a very important road, which join the two most important transbalkan roman vias: the ancient via Egnatia on the south (Ohrid basin) and the Lissus-Naissus on the north (Kukes basin). Being the northern branch of via Egnatia, the Drini i Zi road was the very strategic corridor through the prehistoric times to nowadays.

At Koxhaxhik's castle there are some traces of its inhabitation since the late bronze age and early iron age, as well as the late antiquity period and the mediaval ones. There are some parts of its late antiquity period and mediaval ones fortification system, on the upper platform of its even rocking surface. Its even surface has a polygonal plan with perimeter 145m, 58 m long and 34 m wide, and a surface nearly 1600 m². The walls follow the lines (contours) of the crest, except the southern side, including within the defended surface two narrow terraces with good dwelling conditions. The wall used the defense abilities of the rocking crest, somewhere including in its structure the natural rocks, or interrupting itself where its slopes are rocky or very steep ones. The nowadays wall's remains consist by 7 tracts of the surrounding walls, respectively 2 m, 3.5 m, 6 m,

2.10m, 9 m, 6 m and 22 m long and its seeing perimeter 50.60 m. (*fig. 6. The outline plan of Koxhaxhik's castle*).

The wall of the late antiquity period is actually the earliest fortification of Koxhaxhik's castle. We could see it in the outer line wall of its tower. It had been builded with river and natural stones related with limestones mortar, by *opus incertum* technique.

The castle had nearly been refortificated in medieval period, fulfilling the damaged parts and rebuilding the new ones lines of them. To the medieval period belong all the remains tracts, named A-G, 50.60 m long in generally, including the outer second wall of the its tower. Their height moves from 1.00 m to 2.5- 3m, whereas their width moves from 1.40 to 1.70m. A similar width of surrounding walls have already been seen in some other medieval castles of Albania, such as the castle of Kruja, Shurdhahu(near Scodra), Daula(Kurbin), Stelushi(Diber-Mat), Guri i Bardhë(Petralba) etc.

In the chronological viewpoint, the medieval fortification of Koxhaxhik's castle belong to the XIV-XV centuries A.D. To this period conform the technique of building of the surrounding walls, their narrow width, the tecniques features of the mortar determinated by the limestones, the using of the iron building scaffold etc.

To the medieval preosman period of the XIV-XV centuries A.D. belong nearly all the the fragments of vessels founded on this castle and its varosh. There are a prevalence of the kitchen vessels with brown and brown to black colour clay, with good baking towards the sparse table ones with cleaner clay in ocras or light red colour, sometimes decorated in white geometric painting. The similar forms of vessels have been discovered in some other medieval castles, such as at the castle of Stelush, Guri i Pishkashit, Petrela, Daula, Kruja etc.

The new archaeological data confirm that this castle had been inhabited since the late bronze age and the early iron age. It had been fortificated with surrounding walls for the first time at the late antiquity period, whereas at the medieval ones, nearly at XIV-XV centuries A.D it had been refortificated. This period was the most intensed life ones on this castle and its varosh. The above mentioned archaeological and historical arguments make us to believe that the wellknown medieval towns of Sfetigrade can be identified in the Koxhaxhik's castle and its varosh.